




DREJTORIA PERGJITHSHME
E BURGJEVE



Raporti Teknik

**"PROJEKTI I HIDROIZOLIMIT TË TARRACAVE, MURIT
RRETHUES TË REGJIMIT TË BRENDSHËM DHE
KULLAVE TË VROJTIMEVE TË IEVP LUSHNJË"**



PËRMBAJTJA

1.Përshkrimi i përgjithshëm.....	3
1.1 Vendodhja.....	3
1.2 Gjendja ekzistuese.....	3
2.Kërkesa projektimi të përgjithshme për hidroizolim të tarracave, murit rrethues të rregjimit të brendshëm dhe kullave të vrojtimit të IEVP Lushnjë.....	17
3.Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale.....	19
4.Standartet.....	19
5.Konkluzionet/rekomandimet.....	20

1.1 Vendodhja

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lushnjë, është ndërtuar dhe ka fillur funksionimin në vitin 1975. Objekti është i pozicionuar 14.5 km nga qendra e Lushnjës.



Figura 1 Ortofoto e IEVP Lushnjë

1.2 Gjendja Ekzistuese

Objekti IEVP Lushnjë ka një sipërfaqe ndërtimore prej 1109 m² (gjurma e objekteve) sipërfaqe trualli (e përgjithshme) 8547 m². Mungesa e investimeve dhe mirëmbajtjes së objekteve ndër vite, ka sjellë dëmtime dhe degradim të mbulesave/taracave të objekteve. Dëmtimi i tyre favorizohet edhe nga pozicioni gjeografik, kushtet klimaterike të zonës. Tarraca ka nevojë për hidroizolim.

Ullukët e shkarkimit të ujërave të shiut janë të prishura dhe sjellin lagështi në sipërfaqet e mureve ku ato ndodhen.

Në fotot e mëposhtme shihen dhe tarracat e objekteve të cilat janë objekt projekti.



Figura 2 Objektet IEVP Lushnjë

















2.Kërkesa projektimi të përgjithshme për hidroizolim in e tarracave të IEVP Lushnjë

Ne si projektues pasi kemi verifikuar në vend të gjitha problematikat, kemi kryer matjet e nevojshme topografike dhe kemi fotografuar tarracat e objekteve dhe kemi hartuar planet e tyre në përputhje me standartet e projektimit dhe vetë specifikën e këtij institucioni.

Kërkesa projektimi :

- Përsa i përket trajtimit të tarracave të dëmtuara është marrë parasysh rikonstrukcioni i tyre për të shmangur lagështinë duke paraqitur në detaje termoizolim dhe hidroizolim ,mënyrën e ngjitjes së shtresës hidroizoluese në parapetin e tarracës etj.
- Janë paraqitur skemat e kullimit me pjerrësitë përkatëse për cdo objekt , numrat e ulluqeve ,vendodhjet e tyre në tarracë si dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi.

Në projekt kemi treguar skemën e kullimit me pjerrësitë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi.




Figura 3 Profil Tip i shtresave,parapetit,detaj te kullimit

3.Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale

○ Hidroizolimi i Tarracës

Hidroizolimi i taracës është dëmtuar prandaj është vendosur të realizohet hidroizolim i ri.

Në projekt janë dhënë të gjitha detajet e nevojshme për termoizolim dhe hidroizolim të tarracës si dhe për mënyrën e ngjitjes së shtresës hidroizoluese në parapetin e tarracës ,për vendosjen e ullukëve vertikalësi dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve.


Rikonstruksioni i dëmtimeve të pjerrëta do të bëhet duke përdorur llac cemento, pas këtij riparimi do të formohet një shtresë llac cimentoje me trashësi minimum 2 cm të niveluar për krijimin e shtresës izoluese. Shtresa izoluese duhet shtrirë në një sipërfaqe të thatë,të pastruar mirë më parë me shtresë horizontale,pjerrësi si dhe sipërfaqet vertikale.

Zëvendësimi i parapeteve të hequra duke përfshirë riparime të nevojshme e zëvendësim me pllaka të reja duke i fiksuar me llac me cemento.

Termoizolimi do të realizohet duke përdorur materiale termoizoluese(polisterol) të vendosura në formë të pjerrët në zonat e shtresave hidroizoluese.

○ Muri Rrethues

Prishja e murit ekzistues për të ndërtuar murin e ri,përbën problem për funksionimin normal të institucionit, me rrëzimin e murit perimetral bien kushtet e sigurisë së institucionit.



Ndaj muri i ri është propozuar të ndërtohet jashtë perimetrit të sigurisë(murit

ekzistues) ne ato drejtime ku eshte e mundur dhe nuk cenohen pronat ngjitur. Ne ato ane ku nuk eshte e mundur, muri perimetral I rim und te ndertohet Brenda murit perimetral te sigurise.

4. Standartet

Për projektimin e hidroizolimit të tarracave, janë përdorur standardet më të mira për këto objekte specifike në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi , duke u mbështetur në **VKM nr.280, datë 29.04.2022** *“Për Përcaktimin e Rregullave dhe Kritereve të Detajuara për Kushtet Teknike, Sigurinë, Përshtatshmërinë dhe Aksesueshmërinë nga Personat me Aftësi të Kufizuara, që duhet të plotësojnë ndërtesat e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.*

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, grupi i projektimit ka përdorur programet e kërkuara kompjuterike, që janë programet më të reja, e më të avancuar të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit është patur parasysh dhe janë respektuar të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes .



PROJEKTUES
“MCE” sh.p.k
Ing.Petrit Muja